

V E N D I M
Nr.311, datë 12.6.1995

**PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRIVE
SHTETËRORE QË DO TË KRIJOHEN NGA SHNDËRRIMI I NDËRMARRJEVE
SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE**

Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimi i kapitalit të shoqërive shtetërore anonime ose me përgjegjësi të kufizuar që do të krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, do të bëhet duke u mbështetur në të dhënat e bilancit të mbylljes të ushtrimit financiar 1994 dhe në korrigjimet që përcaktohen në këtë vendim.

2. Shuma e kapitalit themeltar të shoqërisë do të formohet nga shuma e këtij kapitali në çelje të ushtrimit financiar për vitin 1995, të cilit do t'i shtohen ose do t'i zbriten sipas rastit:

a) Shuma e rezervës së kapitalit të trashëguar nga ushtrimet e mëparshme sipas bilancit të mbylljes për vitin 1994.

b) Shuma e rezervës së kapitalit të krijuar nga shpërndarja e fitimeve të ushtrimit financiar 1994, sipas vendimit të Këshillit drejtues për miratimin e llogarive vjetore.

c) Shuma e rezervës së zhvillimit të trashëguar nga ushtrimet e mëparshme sipas bilancit të mbylljes për vitin 1994.

ç) Shuma e rezervës së zhvillimit të krijuar nga shpërndarja e fitimeve të ushtrimit financiar 1994, sipas vendimit të Këshillit drejtues për miratimin e llogarive vjetore.

d) Shuma e rezervës të shpërblimit suplementar të mbetur pas dhënies së shpërblimeve për llogari të ushtrimit financiar 1994.

dh) Shuma e rezervës për ndihma të menjëhershme shoqërore që tejkalon 20 për qind të fondit të pagave të llogarit për ushtrimin financiar 1995.

e) Shuma e humbjeve të mbartura dhe, nëse është rasti, shuma e humbjeve të ushtrimit 1994.

ë) Shuma të tjera që figurojnë në pasiv të bilancit për mbylljen e ushtrimit financiar 1994, të cilat do të përfshihen në kapitalin themeltar të shoqërisë me urdhër të ministrit të Financave, duke përjashtuar fondet e caktuara për ndërtimin e banesave për punonjësit kur për këto është marrë miratimi i organeve kompetente.

3. Kërkesat debitoare dhe detyrimet kreditore ndërmjet ndërmarrjeve shtetërore me njëra-tjetrën do të inventarizohen dhe paraqiten veças në bilancin e riformuar të shoqërisë shtetërore që krijohet nga transformimi i ndërmarrjes.

Ndërmarrjet shtetërore ose shoqëritë shtetërore mund të kryejnë kompensimin e detyrimeve të ndërsjella ndërmjet tyre.

Ministri i Financave mund të urdhërojë një ndërmarrje a shoqëri shtetërore që të heqë dorë nga kërkimi i detyrimit mbi një ndërmarrje ose shoqëri shtetërore tjetër, kur një gjë e tillë nuk sjell për kreditorin pakësimin e kapitalit nën kufijtë e përcaktuar nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

4. Kërkesat debitoare të ndërmarrjes mbi buxhetin e shtetit dhe mbi institucionet buxhetore, qendrore e lokale, si dhe detyrimet kreditore të ndërmarrjes ndaj këtyre të fundit, do të inventarizohen veças dhe do të paraqiten më vete në bilancin e riformuar të shoqërisë, që krijohet nga transformimi i ndërmarrjes.

Sistemimi i këtyre kërkesave dhe detyrimeve mund të bëhet vetëm me ligj.

5. Në rastet kur vlera kontabël e mbetur e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara është më e ulët se vlera aktuale, do të kryhet rivlerësimi i tyre. Rivlerësimi do të kryhet sipas kriterëve të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.47, datë 7.2.1994, por pa marrë parasysh:

- Shpenzimet për meremetimet e mëdha dhe pjesën e normës së amortizimit për këto meremetime.

- Koeficientin korrektues 0.2 për makineritë dhe pajisjet. Korrigjimi i vlerës kontabël të

mbetur do të bëhet në bazë të koeficientit të indeksit të muajit maj 1995, i cili është 5.4.

Diferencat nga rivlerësimi do të merren në llogari për përcaktimin e kapitalit themeltar.

6. Në rastet kur ka elemente pasurie pa vlerë përdorimi apo të zhvlerësuar, do të procedohet në nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit ose në uljen e vlerës.

Nxjerrje jashtë përdorimit do të kryhet në pajtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993.

Ulja e vlerës do të kryhet nga komisioni i vlerësimit dhe me pjesëmarrjen e dy apo më shumë ekspertësh të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë.

Nxjerrjet jashtë përdorimit miratohen sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993, kurse ulja e vlerave miratohen nga këshilli drejtues i ndërmarrjes.

Vlerat e nxjerrjeve jashtë përdorimit dhe shumat e zhvlerësimeve do të merren në llogari për përcaktimin e kapitalit themeltar.

7. Efektet pasurore të veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë ushtrimit financiar 1995 do të mbahen të pandryshuara ashtu siç rezultojnë nga regjistrimet në kontabilitetin e ndërmarrjes deri në datën e vlerësimit të kapitalit për efekt të transformimit, me përjashtim të rastit kur zbulohen gabime që duhen korrigjuar si zakonisht.

8. Bilanci i çeljes së shoqërisë së krijuar nga transformimi i ndërmarrjes shtetërore do të hartohet sipas rregullave të caktuara me udhëzim të ministrit të Financave, i cili mund të nxjerrë edhe akte të tjera me karakter rregullues për zbatimin e këtij vendimi.

9. Përcaktimi i kapitalit të shoqërive shtetërore do të bëhet nga një komision i ngritur pranë çdo ndërmarrjeje me urdhër të titullarit të saj.

10. Bilanci i çeljes i shoqërisë do të verifikohet dhe do të vërtetohet nga një ekspert kontabël, i zgjedhur nga listat e miratuara nga ministri i Financave në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.507, datë 24.10.1994. Zgjedhja e ekspertit do të bëhet nga Drejtoria e Shoqërive Publike.

11. Madhësia e kapitalit themeltar të nevojshëm për shoqëritë që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, vendoset nga ministri i Financave.

Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë një shumë kapitali më të vogël nga shuma që rezulton nga llogaritjet e bëra sipas këtij vendimi dhe të urdhërojë tërheqjen e diferencës në një llogari të posaçme të fondit rezervë të shoqërive publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi